



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

V E N D I M

NR. 14 DATË 14.07.2009

PËR

**MIRATIMIN E STUDIMIT URBANISTIK PJESOR NË FSHATIN LANABREGAS NË
KOMUNËN DAJT, NË QARKUN E TIRANËS**

Në mbështetje të neneve 7, 9 të Ligjit 8405 dt. 17.09.1998 "Për Urbanistikën", me ndryshimet përkatëse dhe Vendimit Nr.836 datë 03.12.2004 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar me VKM 717 dt 22.11.2005; miratuar nga KRRT e Komunës Dajt me Vendimin Nr.112, datë 18.12.2008

duke marrë në konsideratë mendimin e Sekretarisë Teknike të KRRTRSH dhe diskutimet e anëtarëve të saj;

Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I :

1. Të miratohet "Studimi urbanistik pjesor në territorin me sipërfaqe 73 ha , në fshatin Lanabregas në Komunën Dajt, në Qarkun e Tiranës" dhe Rregullorja për zbatimin e tij.
2. Në fazën e miratimit të studimit, materiali të pajiset me miratimin nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.
3. Në lidhje me furnizimin me ujë të kësaj zone të merret pika e furnizimit në Ndërmarrjen e Ujësjellësit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

SALI BËRISHA



**PËR SEKRETARINË TEKNIKE TË KËSHILLIT TË RREGULLIMIT TË
TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

KRYETARI

ERNEST NOKA



SEKRETARE E KRRTRSH

KREUZA LEKA

